

RELACION TEKNIK

**STUDIM PROJEKTIM PER OBJEKTIN:
ASFALTIMI I RRUGEVE TE BRENDSHME**

BASHKIA BELSH

PROJEKT

SHOQERIA "NOVATECH STUDIO" SHPK RRUGA Myrteza Topi

Tiranë Njësia bashkiake nr 8, rruga Shenasi Dishnica

cel 0682065950

E-mail: novatechstudio@gmail.com

Tirane-Albania

*** Tiranë 2023***

1. Te Pergjitheshme

Bashkia e Beleshit shtrihet në zonën e [Dumresë](#), në një zonë që shquhet nga numri i madh i liqeneve dhe me një peizazh tërheqës, Belshi është një qytet i vogël buzë liqenit me të njëjtin emër, kryeqendra tradicionale e zonës së [Dumresë](#).

Pas marrjes se detyres se projektimit për objektin e mesipër u fillua nga puna për konkretizimin e projektit.

Në BASHKINE BELESH jetojnë një komunitet i madh banorësh autoktone. Deri më sot në këto bashki janë bërë investime jo të mjaftueshme në infrastrukturë rurale, përse i përket fshatrave të kësaj bashkie. Këto fshatra e kanë të domosdoshme ndertimin dhe sistemimin e rrugëve lidhëse. Ndertimi i këtij rrjeti rrugor do të shfrytëzojë rrugët ekzistuese që lidh fshatrat me qytetin dhe me fshatrat e tjera përreth.

Gjithashtu, kjo rrugë do të krijojë mundësi më të mëdha edhe për investime të tjera në këtë zonë, si në fushën e bujqësisë, blegtorisë, por edhe për një jetesë me të kulturuar si dhe për zhvillimin e turizmit. Me ndërtimin e rrugës e me vone të rrjetit të kanalizimeve e të rrjetit të ujësjellsit për çdo lagje mendojmë që do të këto investime të tjera jo vetëm tregëtare e bujqësore por edhe në fushën e turizmit, që nënkupton kthimin e banorëve të larguar dhe rindërtimin e banesave të tyre për qëllime turistike, fakt që do të çonte në rigjallërimin e këtij rajoni e të jetesës në përgjithësi.

Meqënëse kjo zonë është një zonë fushore kodrinore realizimi i investimeve të mësipërme do të ndikonte fuqishëm dhe direkt në rritjen e mirëqënies së këtij komuniteti.

2. Kushtet klimatike të zonës:

Kushtet klimatike të zonës karakterizohen nga një klimë mesdhetare e kontinentale përgjithësisht e lagësht dhe jo e ftohtë në dimër dhe me verë të nxehtë dhe të thatë.

Temperatura mesatare maksimale varion nga 11.0 C në janar deri në 31.20 C në korrik. Temperatura mesatare minimale varion nga 2.20 C në janar deri në 15.80 C në korrik. Temperatura minimale absolute është rregjistruar -7.50 C dhe ajo maksimale absolute 42.0 C.

Ngricat janë krvesisht në muajt dhjetor-shkurt, që rrallë herë mund të këto shtresë akulli e cila nuk i kalon 3 cm.

Temperatura mesatare e ajrit varion nga 6.70 C në janar deri në 23.40 C në korrik.

3.Pershkrimi i Projektit

3.1- Riasfaltimi i rrugeve te brendshme Belsh

Ky projekt konsiston në sistemimin dhe asfaltimin e disa segmenteve rrugore në Bashkinë Belsh duke përfshirë qendër Belsh dhe disa fshatra rreth qytetit të Belshit.


Ky projekt përfshin segmentet rrugore si më poshtë:

- Rrugë Kosovë 1+2
- Rrugë Fierzë 1+2
- Rrugë në fshatin Kajan
- Rrugë Lokalitet 1+2
- Rrugë në fshatin Grekan
- Rrugë në Gurraj
- Rrugë në fshatin Turbull
- Rrugë në fshatin Dëshiran 1+2
- Rrugë në fshatin Dragot 1 dhe Dragot 2
- Rrugë Qafëshkallë 1 + 2 + 3
- Rrugë në fshatin Shkëndij
- Rrugë të brendshme Belsh – Qendër
- Rrugë në fshatin Seferan 1+2
- Rrugë në fshatin Gradisht
- Rrugë në fshatin Marinëz 1+2+ 3+4

Gjendja e rrugëve ekzistuese është e degraduar dhe vështirëson kalimin e mjeteve në rrugë. Projekti parashikon ndërtimin e rrugës me gjërësi asfalti 3m dhe trup rruge me gjërësi 4.5m. Përjashtim bëjnë rrugët në fshatin Grekan, Dragot 2, Seferan, Marinëz ku parashikohet rrugë me gjërësi asfaltike 3.5m dhe trup rruge me gjërësi 5m.

Gjithashtu parashikohen vendosjen e tobinove me diametër Ø400mm, Ø600mm dhe Ø1000mm për sistemimin e ujrave të bardha.

PROFILI TIP



- **Bankina e kesaj rruge do te jete 0.75ml, ne te dy anet ne cakell.**
- **Nenshtresa Cakelli 20cm**
- **Stabilizant 10 cm**
- **Shtresë binderi mix 6cm**

Eshte menduar qe te perdoret edhe material rrethanor shkembor per mbushjen e trasese dhe per formimin e trupit te rruges ne vende te caktuara. Keto shtresa do te ngjeshen secila me rrul 8-12 ton me nga 6-9 kalime secila shtrese. Nje cikël i tille ngjeshje duhet te perdoret edhe per nenshtresat rrugore.

REFERIMI I ZERAVE TE PUNIMEVE

Ne kete material percaktohen operacionet perberese te cdo zeri pune ne preventiv. Kjo sherben per nje percaktim te sakte te cmimit te ofertes per cdo ze pune.

- **Mbushje dhe profilim traseje rruge.**

Ky cmim perfshin te gjitha shpenzimet per blerjen, transportin dhe shtrimin per mbushjen e trupit te rruges me material cakull meturina te guroreve ose material tjetër rrethor te pershtatshem te miratuar paraprakisht nga Supervizori, realizimin e trupit te rruges dhe bankinave sipas projektit, ngjeshjen me shtresa dhe trajtimin e tyre . Ngjeshja duhet te behet me shtresa sipas KTZ-se. Materiali duhet te kete lageshtine dhe konsistencen e duhur per te arritur koeficientin e ngjeshjes optimale. Ky cmim i referohet nje njesie me operacionet e mesiperme.

- **Shtrese cakulli guroreje (20) cm**

Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe te puntorise qe lidhet me blerjen e cakullit guroreje, ngarkimin, transportin, dhe helljen ne veper si dhe rrulimi me rrul 8-12 ton me 6-8 kalime vajtje – ardhje, sipas kushteve teknike te zbatimit, sipas profilit te paraqitur ne projekt . Ky cmim i referohet 1m².

- **Shtrese Stabilizanti (10) cm**

Ky cmim perfshin teresine e punimeve dhe te puntorise qe lidhet me blerjen e stabilizantit, ngarkimin, transportin, dhe helljen ne veper si dhe rrulimi me rrul 8-12 ton me 6-8 kalime vajtje – ardhje, sipas kushteve teknike te zbatimit, sipas profilit te paraqitur ne projekt. Ky cmim i referohet 1m².

- **Strese binderi mix (6) cm.**

Ne kete cmim perfshihet kostoja e punimeve dhe e puntorise qe lidhet me blerjen dhe helljen ne veper te shtreses se asfaltobetonit, pavaresisht nese ky kryhet me krahe apo me makineri. Ketu perfshihet edhe kostoja e cilindrimit me rrul 10-12 ton per sicilen shtrese. Binder mix i perdorur duhet ti pergjigjet te gjitha kushteve teknike ne fuqi . Cmimi i pergjigjet 1m².

- **Sperkatje me bitum te siperfaqes.**

Ne kete ze perfshihet pastrami i siperfaqes dhe sperkatja me bitum I siperfaqes ne te cilen do te hillet binderi apo asfaltobetoni. Materiali I perdorur duhet te plotesoje kushtet teknike ne fuqi. Ky cmim I pergjigjet 1m².

- **Betonime monolite M-150/200**

Ky cmim perfshin te gjitha shpenzimet per furnizimin, transportin, e depozitimin e materialeve ne objekt, realizimin e kallepeve te derrases sipas dimensioneve dhe betonimin e kunetave,kanalit te betonit dhe pusetave , portaleve me beton M-150(200). Kallepet duhet te realizohen me derrase te paster, sipas dimensioneve te kerkuara dhe te vendosura sipas projektit. Betoni duhet te realizohet me inerte lara me granulometrine e duhur dhe sipas normativave te percaktuara per betone te markes 150(200) si dhe ne konsistencen e duhur. Ketu futet edhe trajtimi i betonit me uje sipas KTZ- se ne fuqi. Duhet te mbahen kubiket e proves per cdo dite dhe marke ne prani te supervizionit. Ky cmim i referohet 1m³ beton.

- **Punime germimi.**


Ne punimet e germimit perfshihet teresia e punimeve si germim i seksioneve te percaktuara ne projekt, ngarkimi i tyre ne automjet si dhe transporti i tyre ne nje vend te pershtatshem e te lejuar per depozitim dherash. Cmimi i pergjigjet 1 m³.

- **Punime germimi kasonete.**

Ne punimet e germimit per kasonete perfshihet teresia e punimeve si germim i seksioneve te percaktuara ne projekt, ngarkimi i tyre ne automjet si dhe transporti i tyre ne nje vend te pershtatshem e te lejuar per depozitim dherash. Cmimi i pergjigjet 1 m³.

- **Vendosje tubo per tombino**

TOMBINO Ø 400mm, 600mm dhe Ø1000mm



Per te realizuar mire funksionimin e kanaleve ansore ne te gjithë gjatesine jane parashikuar qe ne cdo hyrje banese te realizohet nga nje tombino me dimensione nga 300-400 ml sipas pozicionit te percaktuar ne projekt. Ne kete ze parashikohet si blerja e tubove transporti, e deri tek vendosja e tyre ne objekt.

Ky ze mund te negociohet me banoret perkates qe kete ze pune ta perballojne ata nese ka mundesi, ne projekt parashikohen qe te dy variantet. Kjo procedure perlllogaritje eshte perdorur edhe ne dimensionet e tjera te tombinove. Cmimi i perket nje ml tubi.

Per cdo problem qe do te dale gjate zbatimit te objektit do te lajmerohet Supervizori si dhe Projektuesi i cili duhet te beje miratimin e ndryshimeve. ndryshime apo plotesim ne permiresimin e zbatimit te ketij projekti kane vlere me miratimin perkates te investitorit.

Shenim: Projekti parashikon ndertimin e disa segmenteve rrugore te shtrira pothuaj ne te gjithë territorin e bashkis.

Punimet e parashikuara ne preventiv janë vetëm orientuese referuar gjendjes aktuale te rrugeve ne momentin e hartimit te projektit. Zerat dhe volumet e sakta per sejcilen rruge do te percaktohen rast pas rasti ne varesi te mundesive finaciare te bashkise per realizimin e tyre si dhe nevojës prioritare te realizimit te punimeve ne sejcilen rruge.

Duke qene rruge neper fshatra dhe me gjendje aktuale te degraduar, situata ne to ndryshon vazhdimisht ne varesi te fluskit te levizjes mjeteve te renda ne to dhe kushteve te rreshjeve atmosferike.

Per keto arsye projekti do te kete nevojë per azhornime ne vijimesi ne varesi te kohes kur do te realizohen punimet.

A U T O R
STUDIO "NOVATECH" SH.P.K.
ADMINISTRATORI
Ing. Emil NOVA